



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 2699/6 prot.

Elbasan, me 28.10.2024

VENDIM

Nr. 55, datë 28.10.2024

Për
shpronësimin publik të pasurisë nr. 7/133 për objektin: "Godinë 4 kate me 2 kate
nëntokë në funksion të Fakultetit të Shkencave Mjekesore Teknike të Universitetit të
Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'"

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, Ligjit Nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, VKM nr. 66, datë 03.02.2021, me të cilin është miratuar kalimi në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale te Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.08 datë 08.03.2023 "Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: "Godinë 4 kate me 2 kate nëntokë në funksion të Fakultetit të Shkencave Mjekesore Teknike pranë Universitetit "Aleksandër Xhuvani", VKM nr. 89, datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shpronësimit të pjesës takuese të pasurisë nr. 7/133, në pronësi të shtetasit Roland Sif Gjini në vlerën 2,428,643 lekë. Mbështetur në VKM nr. 89, datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", shpronësimi i pasurisë nr. 7/133 në ZK 8525 Bashkia Elbasan, çmimi tokë truall është 14,192 lek/m². Mbështetur në Udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2016 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2016", e në vijim, çmimi i koston mesatare i sipërfaqes së ndërtimit është 32,331 lek/m². Kosto e shpronësimit total përlllogarit 2,428,643 lekë (Sipërfaqe tokë truall 59.5 m² x 14,192 lek/m² = 844,424 lekë, sipërfaqe e ndërtimit 49 m² x 32,331 lek/m² = 1,584,219 lekë).



Pasuria për shpronësim nr. 7/133 është pjesë takuese me pasurinë nr. 7/19/2 dhe pasurinë nr. 7/215 në ZK 8525, Elbasan dhe pjesërisht ndodhet në pasurinë nr. 7/19/2 në përgjegjësi administrimi të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

Mbi këto pasuri të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, kanë filluar punimet me objekt “Ndërtim i godinës së Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike – FSHMT”.

2. Pronari i pjesës takuese, shtetasi Roland Sif Gjini, ka dhënë pëlqimin e tij për shpronësimin e objektit, sipas Deklaratës Noteriale me Nr. Repertori 4923 dhe koleksioni 2191, datë 21.10.2024.
3. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për procedura të mëtejshme.
4. Ngarkohet Administratori i Universitetit “Aleksandër Xhuvani” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT

Dr. Ardian Durrmishi

